



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:252336
Datë: 25.04.2024
Numri i dokumentit: 05621128

Ac.nr.138/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj kryetar i kolegjit, Faton Ademi dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S. G. nga Prishtina, rr. “M. F.” – Mati ..., nr. ... “Elita”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat A. K. nga Prishtina, Rr. “G.” .../1, kati ..., Nr.... kundër të paditurit A. (E.) F. nga Prishtina, Lagjja Ulpianë D... – Hyrja..., Nr...., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat D. R. nga Prishtina, Rr. “F. A.” Hy.-.../4, për shkak të kompensimit të dëmit jo material, duke vendosur lidhur me ankesat e paditësit dhe të paditurit, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil C.nr.1251/2015 datë 17.09.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN të pa themelta ankesat e paditësit S. G. nga Prishtina, rr. “M. F.” – Mati..., nr.... “Elita” dhe të paditurit A. (E.) F. nga Prishtina, Lagjja Ulpianë D...– Hyrja ..., Nr....., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil C.nr.1251/2015 datë 17.09.2020, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar, C.nr.1251/2015 datë 17.09.2020, ka vendosur:

- I.** APROVOHET Pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit paditësit S.G. nga Prishtina, me vendbanim në adresën Rr. M. F.– Mati, Nr. ... “Elita”, për kompensimin e dëmit jo material, sipas ekspertizës psikiatrike të datës 06.01.2020.
- II.** DETYROHET i padituri A. (E.) F. nga Prishtina, Lagjja Ulpianë D... – Hyrja, Nr. 1...., që ta kompensojë paditësin S. G. për dëmin jomaterial të shkaktuar, dhe atë:
- në emër të frikës së përjetuar, shumën 500.00 €
 - në emër të dhimbjeve shpirtërore, shumën1’500.00 €,
- në total 2’000.00 € (dy mijë euro), me kamatë ligjore 8% e llogaritur nga data e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.
- III.** REFUZOHET si e pabazuar pjesa e kërkesëpadi së paditësit S. G. nga Prishtina përtej shumave të gjykuara si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, lidhur me kompensimin e dëmit jomaterial.
- IV.** DETYROHET i padituri A. (E.) F. nga Prishtina, që paditësit t`ia paguajë shpenzimet e procedurës në lartësi 809.60 € (tetëqind e nëntë euro e gjashtëdhjetë cent), në afat prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarrimit ligjor.

Kundër këtij aktgjykimi, paditësi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak te zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ta aprovoj ankesën si të bazuar, ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar sa i përket lartësisë së dëmshpërblimit.

Gjithashtu, kundër këtij aktgjykimi, i padituri, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak te vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ta aprovoj ankesën si të bazuar, ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të lartësisë së kërkesës në emër të frikës dhe në emër të dhimbjeve shpirtërore si dhe lartësisë së shpenzimeve të procedurës, ose të njëjtin ta anuloj dhe çështjen ta kthej në gjykatën e shkallës së parë në ri procedurë dhe ri vendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, si dhe shikimin, analizimin dhe vlerësimin shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësit dhe e të paditurit janë të pa themelta.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi S. G. nga Prishtina, përmes të autorizuarit të tij, me datën 29.05.2015, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi, kundër të paditurit A.E. F. nga Prishtina, për shkak të kompensimit të dëmit jo material, me kërkesë si në padinë e parashtruar me shkrim.

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësit, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor, dëgjimit të palëve ndërgjyqëse dhe administrimit të provave, ka marrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.1251/2015 të datës 17.09.2020, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur konkretisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e shkallës së parë, në aktgjykimin e ankimuar ka arsyetuar se: Në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës, P.nr. 3393/11 (Prova nr. 1), i padituri A. F. nga Prishtina është shpallur fajtor në procedurë penale për shkak të kryerjes së veprës “Kanosje” ndaj të dëmtuarit / paditësit - në këtë çështje S. G., dhe ishte dënuar me kusht nga kjo gjykatë. Pala e dëmtuar / paditësi në këtë çështje, është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike. Prandaj kjo gjykatë gjeti se konform nenit 463 par.1 dhe 2 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me dispozitat nga Kapitulli IV i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil vendosi për këtë kontest. Andaj, kjo gjykatë nuk u thellua në shqyrtimin e faktit se a ka pasur kanosje apo jo nga i padituri ndaj paditësit, sepse me Aktgjykimin e lartcekur është vërtetuar se ka pasur një veprë penale të kanosjes, e cila vërteton rrethanat e shaktimit të dëmit jomaterial ndaj paditësit.

Më tej ka arsyetuar se: Në bazë të ekspertizës psikiatrike dhe pas dëgjimit të ekspertes së psikiatrisë Dr. V. S. në seancën e shqyrtimit kryesor, gjykata konstaton se: Në datën 18.11.2011 paditësi ishte nisur për të shkuar në shtëpi pas kujdestarisë në klinikë, kur një automobil i ka blinduar me drita, ngasësi i të cilës ka qenë i padituri – vëllai i ish-bashkëshortes, i cili në një moment ka tentuar ta godasë paditësin, saqë i është afruar shumë afër me automobil dhe pa asnjë shkas ka filluar ta kërcënojë e ta fyejë: “kam më të vra, kam me të kallë”. Nga ky kërcënim paditësi është ndjerë tejet i shqetësuar dhe rrezikuar pasi që me të në veturë ka qenë bashkëshortja e tij shtatzënë në atë kohë. Sipas tij – ai është ndjerë i pa sigurte, nuk ka mundur të flejë, dhe ka qenë i stresuar e i brengosur për sigurinë e tij dhe të familjes së tij. Nga një kërcënim i tillë paditësi kishte deklaruar gjatë ekzaminimit psikiatrik se e ka pasur të vështirë ta tejkalojë një situatë të tillë, se i vinte keq nga e shoqja, dhe akoma edhe sot e përkujton me stres dhe i preokupuar situatën, i cili kishte pasur ndrojtje për fëmijët e sidomos për bashkëshorten shtatzënë. Tutje ai pohon se kjo situatë e ka prekur në sedër dhe e ka lënë net të tëra pa gjumë, i ka dobësuar vizionin për të ardhmen në rrethin ku punon. Kjo e ka përcjellë me ndrojtje se situata e tillë do të ketë pasoja negative edhe në familje me bashkëshorten dhe fëmijët e tij. Nga të gjitha këto, konstatimi psikiatrik rezulton se paditësi ka përjetuar shqetësime psikike si: mërzitje, pasiguri, përballim i kërcënimit e që këto e kanë bërë të vuajnë psikikisht, duke përjetuar dhimbje shpirtërore të intensitetit të lartë në kohëzgjatje 1 javore, dhimbje shpirtërore të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje 3 javore dhe dhimbje të intensitetit të ultë në kohëzgjatje 1 mujore. Andaj, Gjykata e ka pranuar ekspertizën mjekësore si të besueshme, meqë e njëjta ishte profesionale dhe e argumentuar mirë, për të cilën ekspertja me rastin e përpilimit mori për bazë dokumentacionin në shkresat e lëndës, si dhe ka kryer ekzaminimin direkt psikiatrik të paditësit.

Më tej ka arsyetuar se: pas analizimit të hollësishëm të përmbajtjes së ekspertizës të elaboruar si më lartë, e që të njëjtën gjykata e gjeti si të bazuara, nga deklaratimet e palëve të dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata vendosi për aprovim të përsëritshëm të kërkesëpadisë së paditësit, dhe atë lidhur me lartësinë e kompensimit, duke vendosur si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar si më lartë.

Më tej ka arsyetuar se: Lidhur me kërkesën për kompensimin e dëmit jomaterial përtej shumës së gjykuar si në dispozitiv, Gjykata e refuzoi pjesërisht si në pikën III të dispozitivit sepse paditësi nuk e bëri të besueshme me prova të tjera bindëse lartësinë e kërkesës për kompensim.

Vendimi mbi kamatën e gjykuar është marrë në kuptim të nenit 382 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në kuptim të nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes pajtohet me pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë pasi që përfundimi i saj është i rregullt dhe i ligjshëm për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e gjithashtu nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurit se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i kuartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor. Përgjegjësia e të paditurit për kompensimin e dëmit jo material është vërtetuar nga aktgjykimi Penal P.nr.3393/2011 datë 24.09.2014 i lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, përmes së cilit i padituri është shpallur fajtorë për veprën penale kanosje nga neni 161 par. 2 të KPK-së si dhe me provat tjera që gjinden në shkresat e lëndës. Gjendjen faktike për dëmin jo material, për paditësin, gjykata e shkallës së parë e ka provuar përmes mendimit të ekspertit mjeko-ligjor, Dr. V. A. S., Psikiatër, për të gjitha kategoritë e dëmit jo-material duke u bazuar edhe në vlerësim të lirë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, mendimin e ekspertit mjeko-ligjor, gjykata e shkallës së parë, por edhe gjykata e Apelit e vlerëson si profesionale, gjithëpërfshirëse dhe reale, duke pas parasysh natyrën frikës së përjetuar si dhe dhimbjeve shpirtërore dhe se kompensimi i dëmit jo-material në të holla ka për qëllim satisfaksionin për të dëmtuarin dhe jo që të arrihet ndonjë qëllim tjetër shoqëror i këtij kompensimi.

Gjykata e shkallës së parë, ka dhënë shpjegimet e duhura në arsyetim të aktgjykimit, për shumën e gjykuar për frikën si dhe dhimbjet shpirtërore të përjetuara. Andaj, si përfundim e ka marrë për bazë mendimin e ekspertit mjekësore, prandaj, Gjykata e Apelit vlerëson se shumica e provuar për dëmin jo materiale është në përputhje edhe me natyrën e frikës së paditësit si dhe dhimbjeve shpirtërore dhe e njëjta paraqet satisfaksion në raport me frikën, kohëzgjatjen e sajë si dhe kohën e nevojshme për rehabilitim, e cila është konstatuar edhe në raportin e Dr. V. A. S., Psikiatër. Në çdo rast për dëmin jo material, gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimi tu shkoj përshtati qëllimeve që synohen me kompensimin e dëmit jo material e që është satisfaksion për të dëmtuarin.

Gjykata e Apelit nuk i morri për bazë pretendimet e paditësit dhe të paditurit në lidhje me aplikim të gabuar të së drejtës materiale pasi që gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur është bazuar në nenin Neni nenit 136.1 të LMD-së, i cili parasheh që “ *kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë të ia kompensoi, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”, kurse me dispozitën e nenit 140 të LMD-së, i cili parasheh që “ *Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia*”, sipas nenit 14 të LPK-së, i cili parasheh që “ *Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor*”, ndërsa sipas nenit 183 par. 1 të LMD-së, për kompensimin e dëmit material dhe jo material si dhe lartësinë e dëmit, i cili parasheh që “ *Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material*”. Ndërsa në paragrafin 2 të po të njëjtit nen është paraparë që “ *Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror*”. Andaj, gjykata e shkallës së parë është bazuar në dispozitat materialo-juridike të cilave u është referuar, e në përputhje me gjendjen faktike, duke marrë në konsideratë natyrën e frikës, natyrën dhimbjeve shpirtërore dhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit siç janë natyra intensiteti dhe kohëzgjatja e frikës, rrethanat tjera, e sidomos moshën e paditësit si dhe praktika gjyqësore të cilat rezultojnë se shumica e gjykuar është në përputhje me qëllimin shoqëror për kompensimin e dëmit. Gjykata ka vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes të shumës së gjykuar dhe dëmeve që ka pësuar paditësit, duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësit, duke shmangur qëllimet tjera materiale që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit.

Sa i përket vendimit për kamatën e gjykuar nga gjykata e shkallës së parë, edhe gjykata e Apelit e përkrah një vendim të tillë pasi që kamata e gjykuar është në pajtueshmëri të plotë me nenin 382 të LMD-së.

Sa i përket vendimit për shpenzimet procedurale të gjuara nga gjykata e shkallë së parë, edhe gjykata e Apelit e përkrah një vendim të tillë pasi që shpenzimet e aprovuara janë shpenzime në përputhshmëri të plotë me veprimet procedurale, pasi që janë veprime të domosdoshme, e gjithashtu duke pas parasysh edhe suksesin e paditësit në procedurë dhe atë në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së lidhur me tarifën e OAK.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore të palëve ndërgjyqëse, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit në bazë të nenit nenin 194 dhe 195 par. 1 pika d), të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË
AC.nr. 138/2021, me datë 22.04.2024

Kryetar i kolegjit, Gjyqtari
Besnik Bislimaj, d.v